FOL lëvizja

Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry

Transparenca e Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Publike në Kosovë III

Hulumtim politikash: Vlerësimi i transparencës së Komunave

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Prishtinë
Korrik 2012

PËRMBAJTJA faqe

FALËNDERIME 3

RRETH FOL 3

1. Hyrje 4

2. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumentet zyrtare 6

3. Komuna e Prizrenit 8

4. Komuna e Mitrovicës 12

5. Komuna e Gjakovës 15

6. Komuna e Podujevës 18

Përfundime dhe rekomandime 22

FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga “BTD – The Balkan Trust for Democracy” në kuadër të projektit “Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike”. Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i Lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti.

RRETH FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t’i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

1. Hyrje

Ky studim politikash publike është i treti me radhë që kryhet në Kosovë, por i pari që fokusohet në Komuna. Ngjashëm si dy studimet e mëparshme, ai synon të vlerësojë transparencën e Komunave. Marrë parasysh numrin e madh të Komunave dhe kompleksitetin e çështjeve që mbulon ky lloj studimi politikash publike, janë përzgjedhur vetëm katër Komuna: Prizreni, Mitrovica, Gjakova dhe Podujeva. Sidoqoftë, në të ardhmen ky studim synon të mbulojë më tepër Komuna dhe gradualisht të avancohet në një vlerësim më preciz, të bazuar në indikatorë. Studimi fokusohet në atë se deri në çfarë niveli kanë arritur Komunat e përzgjedhura në zhvillimin e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe të strukturave formale e kapaciteteve institucionale për të siguruar zbatimin e dispozitave kushtetuese e ligjore që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet publike dhe për komunikim e informim publik, me qëllim të forcimit të transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut. Ky studim përmbledh të arriturat kryesore dhe punën që bëjnë aktualisht katër Komunat e përfshira në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe të dispozitave përkatëse kushtetuese. Përmbajtja e këtij raporti bazohet në informatat e mbledhura përmes një pyetësori të strukturuar, të plotësuar nga secila Komunë e përzgjedhur gjatë muajve maj – qershor 2012, dhe dokumenteve të dërguara nga këto Komuna.

Studimi fokusohet në këto çështje specifike:

1. *Kornizën ligjore dhe rregullative* në fuqi, përkatësisht dispozitat që përmbajnë Statutet dhe rregulloret komunale për transparencë, të cilat themelojnë dhe rregullojnë funksionimin e strukturave të brendshme institucionale dhe obligojnë Komunat që të kenë kapacitete zbatuese për komunikim dhe informim publik. Kjo gjithashtu përfshin dokumentet që parashohin përgjegjësitë konkrete të strukturave komunale përgjegjëse dhe detyrat specifike të stafit të obliguar për të kryer funksione të komunikimit dhe informimit publik, përkatësisht (Strukturat Organizative/Organogramet – SO/O, Termat e Referencës – TR, dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës – PVP);
2. *Kornizën e politikave dhe planet zbatuese*, përkatësisht dokumentet e mundshme strategjike dhe planet e punës që prekin çështje të komunikimit dhe informimit publik, të cilët dokumente duhet të përmbajnë objektiva dhe aktivitete konkrete në këtë fushë politikash publike;
3. *Kornizën dhe kapacitetet institucionale* për komunikim dhe informim publik, me fokus në ekzistimin dhe funksionimin e strukturave institucionale për këtë qëllim dhe të mekanizmave të funksionimit të tyre (përfshirë strukturat përkatëse hierarkike dhe standardet e brendshme të monitorimit, raportimit e vlerësimit të zbatimit të legjislacionit e të politikave lokale për komunikim dhe informim publik, si dhe ato për vlerësimin e performancës së stafit përkatës), por gjithashtu në kapacitetet humane, financiare dhe teknike për zbatimin e këtij legjislacioni dhe politikash publike dhe
4. *Çështjet e zbatimit,* me fokus në praktikat dhe standardet administrative për komunikim dhe informim publik, përkatësisht në marrëdhëniet me mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe palë të tjera të interesuara (përfshirë komunitetin e biznesit), përfshirjen e tyre në hartimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave në këtë fushë, si dhe çfarëdo masash dhe aktivitetesh shtesë, përtej obligimeve ligjore të ndërmarra nga Komunat për komunikim dhe informim më të mirë të publikut dhe zbatimit të dispozitave përkatëse kushtetuese e ligjore.

Pyetësori i strukturuar, si instrumenti kryesor për mbledhjen e informatave dhe të të dhënave, përbëhej nga 25 komponentë: 24 pyetje dhe një tabelë. Përmes tij është mbledhja e informatave dhe të dhënave kuantitative dhe kualitative mbi secilën çështje. Pyetësorët u janë dërguar Drejtorëve të Administratës dhe zyrtarëve komunalë përgjegjës për marrëdhënie me publikun, kurse Kryetarët e Komunës gjithashtu kanë qenë të informuar. Prandaj këta zyrtarë janë përgjegjës për të gjitha gjetjet që përmban ky raport.

Në hyrje të pyetësorit respondentët janë udhëzuar hollësisht dhe të saktësisht mbi mënyrën e plotësimit të pyetësorit dhe llojin e informatave të kërkuara për të mundësuar një vlerësim sa më të saktë dhe gjithëpërfshirës.

2. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumente publike

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 41, përcakton se "Secili person gëzon të drejtën për qasje në dokumentet zyrtare." Më tej, ajo përcakton se "Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, përveç informatave që janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë, sekreteve biznesore tregtare ose klasifikimit të sigurisë."[1] Përmes kësaj, Kushtetuta krijon të drejta dhe detyrime. Nga njëra anë, ajo qytetarëve u jep të drejtën për qasje pa pagesë dhe të papenguar në dokumentet e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Nga ana tjetër, ajo i detyron institucionet publike që të krijojnë të gjitha mekanizmat dhe infrastrukturën mbështetëse, si dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kësaj të drejte, duke filluar nga zbërthimi i detyrimeve specifike të tyre përmes legjislacionit zbatues, e cili duhet më pastaj të pasqyrohet dhe të zbatohet në kuadër të kornizës së politikave të secilit institucion. Kushtetuta gjithashtu përcakton se kjo e drejtë mund të kufizohet në rastet kur qasja në informatat që përmbajnë dokumentet e caktuara shkel privatësinë, ose kur këto informata paraqesin sekrete biznesore ose duhet të klasifikohen për arsye të sigurisë publike. Më tej, aty përcaktohet se këto kufizime duhet të përcaktohen më në hollësi me ligj.

E ky ligj është Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP). Ky ligj përcakton se zbatimi i tij synon që t'i "[...]garanto[jë] të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuara nga institucionet publike."[2] Ai gjithashtu vendos parimet, kushtet e kufizimet për qasje në dokumente publike dhe rregullat për ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte. Më tej, sa u përket specifikisht Komunave, neni 123(4) i Kushtetutës përcakton se "Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.", kurse neni 124(1) përcakton se "Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale." Së treti, Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale[3], në nenin 68, përcakton parimet themelore dhe obligimet e Komunave sa i përket transparencës, informimit e konsultimit të publikut dhe sigurimit të pjesëmarrjes së publikut ne vetëqeverisje lokale. Pa hyrë në hollësi të mëtejshme mbi mënyrat dhe procedurat e qasjes në dokumente publike, me rëndësi parësore është zbatimi i këtyre obligimeve në mënyrë të efektshme nga ana e institucioneve publike. Kjo i obligon ato që të vendosin dhe vënë në funksion tërë infrastrukturën e nevojshme ligjore e institucionale dhe kapacitetet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

Sa u përket akteve nënligjore për zbatimin e LQDP, ky ligj e obligon Qeverinë që brenda tre muajsh pas hyrjes së tij në fuqi të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e tij[4], por megjithatë nuk specifikon as fushëveprimin e as numrin e këtyre akteve. Baza ligjore zbatuese duhet në veçanti të përcaktojnë strukturat, resurset dhe obligimet përkatëse specifike brenda secilit institucion për komunikim dhe informim publik, si dhe mekanizmat e masat zbatuese për të arritur këtë, përfshirë çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga dokumentet publike në të cilat gëzohet e drejta

[1] *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 41, në dispozicion në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf
[2] *Ligji për Qasje në Dokumente Publike*, neni 1, në dispozicion në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-215-alb.pdf
[3] *Ligji për Vetëqeverisje Lokale*, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf
[4] Poaty, neni 26, paragrafi 1 dhe 2

për qasje. Për të përmbushur obligimet përkatëse në kuadër të strukturave e mekanizmave zbatues, secili institucion nevojitet të vendosë infrastrukturën rregullative e teknike përkatëse: reflektimin e resurseve dhe obligimeve në kuadër të strukturës së tyre organizative/organogramit, ekzistencën e Termave të Referencës (TR) dhe Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP), të cilat përcaktojnë konkretisht përgjegjësitë e strukturave institucionale për komunikim dhe informim publik dhe detyrat konkrete të stafit përkatës.

Përveç këtyre, zbatimi efektiv i kornizës ligjore e rregullative kërkon ekzistencën e standardeve të brendshme të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të punës së tyre, alokimin e resurseve të mjaftueshme (humane, financiare e teknike) për funksionimin e këtyre strukturave të brendshme, përfshirë zbatimin e dokumenteve të politikave e planeve relevante të punës. Sa u përket këtyre të fundit, komponenti i komunikimit dhe informimit publik duhet të pasqyrohet në të gjitha, në formë objektivash e aktivitetesh specifike, në kuadër të afateve kohore. Së fundi, por jo vetëm kjo, nevojiten praktika administrative në mënyrë që brenda secilit institucioni/ndërmarrjeje publike të krijohet dhe zhvillohet një kulturë që promovon komunikimin e rregullt me dhe përfshirjen e mediave dhe organizatave të shoqërisë civile në punën e rregullt të tyre, në veçanti në hartimin, implementimin dhe monitorimin e vlerësimin e implementimit të kornizës ligjore përkatëse dhe asaj të politikave.

Pjesa në vijim paraqet gjetjet nga secila Komunë e përzgjedhur.

3. Komuna e Prizrenit

Statuti i Komunës së Prizrenit, i cili ka hyrë në fuqi më 15 tetor 2008, vendos një numër mekanizmash për të siguruar qasjen në dokumente publike të saj dhe transparencën e punës së organeve komunale. Sipas këtij statuti, mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve janë të hapura për publikun, përveç në rastet kur një gjë e tillë mund të rrezikojë sigurinë publike ose kur janë në pyetje informata senzitive, siç janë ato që janë të klasifikuara si të besueshme nga LQDP, ose të natyrës personale, biznesore dhe që ka të bëjë me procedura gjyqësore. Në raste të mbledhjeve të mbyllura, publiku duhet të informohet mbi arsyet e kësaj.[5] Përveç kësaj, Statuti obligon që mbledhjet e Kuvendit Komunal, të komiteteve të tij dhe të gjitha tubimet publike të mbahen në gjuhët zyrtare dhe ato në përdorim zyrtar në këtë Komunë, përkatësisht në shqip, serbisht, boshnjakisht dhe turqisht.[6] Më tej, Kuvendi Komunal është i obliguar të publikojë njoftime publike para secilës mbledhjeje të tij. Këto njoftime duhet të përmbajnë propozimin e rendit të ditës, datën, orën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, dhe duhet të publikohen të paktën shtatë ditë pune para mbledhjes përkatëse, ose në raste urgjente (përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme) tri ditë më herët.[7] Në nivel të strukturave institucionale, Statuti e obligon Kuvendin Komunal që të themelojë, në çdo kohë dhe sipas nevojës, komitete këshillëdhënëse, me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Këto komitete përbëhen nga anëtarë të Kuvendit Komunal, si dhe qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.[8]

Në nivel të zhvillimit të legjislacionit dhe politikave lokale, Statuti i kësaj Komune përmban dispozita të veçanta për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në këtë proces, sipas të cilave qytetarët mund t'i propozojnë Kuvendit për shqyrtim çështjet me interes publik, përmes konsultimeve, dhe mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në tubime, varësisht nga dispozitat e këtij Statuti. Ky i fundit parasheh një numër mekanizmash për realizimin e kësaj: fushata informative dhe të publicitetit, kontakte me qarqe të zgjedhura, anketa lidhur me zbatimin e politikave lokale, shpallje publike të propozimeve lidhur me politikat apo draft-rregullore lokale, kontakte me grupe të interesit, takime publike, seanca publike, hulumtime të opinionit publik, komitete këshillëdhënëse, peticione dhe referendume lokale.[9] Tubimet e rregullta publike me qytetarët paraqesin mekanizmin më gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës të paraparë me Statut. Komuna është e obliguar që të organizojë tubime të tilla së paku dy herë në vit, në të cilat tubime përfaqësuesit komunalë informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikave komunale. Këto tubime janë të hapura për mbarë publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik, dhe në to pjesëmarrësit mund të marrin nisma, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara, në pajtim me dispozitat e Statutit. Koha, dita dhe vendi i mbajtjes së tyre shpallet nga Komuna përmes mjeteve të informimit publik, dy javë para mbajtjes së tyre.[10]

Komuna gjithashtu obligohet të publikojë raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal të Komunës, dhe pas miratimit nga Kuvendi Komunal.[11] Së fundi, Komuna obligohet të mundësojë qasjen e publikut në aktet formale dhe dokumentet e informatat zyrtare të saj. Kryetari i Komunës është i obliguar që të sigurojë qasjen e publikut në tërë dokumente publike që përshkruajnë detyrat dhe kompetencat e

---

[5] *Statuti i Komunës së Prizrenit*, neni 33, në dispozicion në http://kk.rks-gov.net/prizren/Kuvendi-(1)/Statut.aspx
[6] Poaty, neni 12
[7] Poaty, neni 32
[8] Poaty, neni 58
[9] Poaty, neni 89 dhe 90
[10] Poaty, neni 92
[11] Poaty, neni 78

Komunës, organizimin e brendshëm të saj dhe mënyrën e qasjes në shërbimet që ofron, në pajtim me dispozitat e LQDP, përveç kur me ligj kërkohet ndryshe.[12]

Komuna e Prizrenit gjithashtu ka vënë në fuqi ***Rregulloren Komunale për Transparencë***, e cila është miratuar më 29 shkurt 2012 nga Kuvendi Komunal. Kjo rregullore ka tri qëllime kryesore: forcimin e transparencës së punës së organeve komunale, vendosjen e rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të së drejtës për qasje në dokumente publike të Komunës dhe zbatimin e praktikave më të mira administrative për qasje në dokumente zyrtare të saj.[13] Ajo synon të arrijë këto qëllime duke rregulluar specifikisht pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe të komiteteve të tij, tubimet publike të organizuara nga Komuna dhe organet e saj (përfshirë njoftimin e publikut për këto tubime), konsultimet lidhur me aktet e Komunës, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.[14]

Në hyrje të dispozitave operative, përkatësisht te përkufizimet, ka një paqartësi të bazës ligjore. Kjo pasi që 'qasja në dokumente publike' është përkufizuar si "shikimi dhe pajisja me kopje të dokumenteve zyrtare të Komunës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për qasje në dokumente zyrtare"[15], pra si bazë ligjore merret Ligji nr. 2003/12 për Qasje në Dokumente Zyrtare, i cili është shfuqizuar shprehimisht nga Ligji për Qasje në Dokumente Publike.[16] Përveç paqartësisë sa i përket vlefshmërisë formale të këtij neni, dhe rrjedhimisht të tërë rregullores, paqartësia e përkufizimit të këtij termi kyç krijon paqartësi në zbatim. Kjo pasi që lë hapur mundësi për interpretime të ndryshme të fushëveprimit të rregullores, për faktin se përkufizimi 'dokument zyrtar'[17] në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike është shumë më preciz dhe me i hollësishëm sesa përkufizimi 'dokument'[18] në Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në mbledhjet e Kuvendit Komunal[19], pjesa dërrmuese e dispozitave në thelb nuk dallojnë nga dispozitat e Statutit që rregullojnë këtë çështje, përveç formave të njoftimit të publikut për këto mbledhje (shpallje publike, mediave dhe ueb-faqes së Komunës), përmbajtjes së tyre (një dispozitë më tepër që kërkon precizimin e vendit se ku qytetarët mund të furnizohen me materialin e propozuar për shqyrtim), si dhe obligimit që të gjitha rregulloret dhe vendimet e Komunës, publikimi i të cilave lejohet sipas legjislacionit në fuqi për qasje në dokumente zyrtare, të publikohen në ueb-faqen e Komunës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas mbajtjes së mbledhjes në të cilat janë marrë ato. Duke përmendur shprehimisht vetëm rregulloret dhe vendimet si dokumente të Kuvendit Komunal të cilat duhet publikuar detyrimisht, kjo rregullore, në vend se të lehtësojë ushtrimin e së drejtës së qytetarëve për qasje në dokumente publike dhe zbatimin e dispozitave përkatëse të legjislacionit kombëtar, në fakt ngushton fushëveprimin e këtyre dispozitave. Përveç kësaj, kjo rregullore vendos numër të pamjaftueshëm mekanizmash e as nuk parasheh masa proaktive që duhet ndërmarrë Komuna për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në të gjitha dokumentet publike që shqyrtohen dhe nxirren nga puna e Kuvendit Komunal. Së fundi, ajo nuk parasheh ndonjë obligim specifik për Zyrën Komunale për Marrëdhënie me Publikun për të lehtësuar ushtrimin e kësaj të drejte, e as nuk vendos ndonjë mekanizëm për adresimin në vazhdimësi të çështjeve që mund t'i

[12] Poaty, neni 102
[13] *Rregullorja Komunale për Transparencë*, neni 1, Komuna e Prizrenit, në dispozicion në http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Kuvendi-(1)/Regulations/RregullorjaTransparenc.pdf.aspx
[14] Poaty, neni 2
[15] Poaty, neni 3.8
[16] *Ligji për Qasje në Dokumente Publike*, neni 28.1.1
[17] Poaty, neni 3.1.3
[18] *Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare*, neni 2(b), në dispozicion në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_12_al.pdf
[19] *Rregullorja Komunale për Transparencë*, neni 4, Komuna e Prizrenit

adresohen Kuvendit Komunal nga ana e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues të tjerë të publikut që marrin pjesë në mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të tij.

Edhe dispozita që mëton të rregullojë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në mbledhjet e komiteteve të përhershme të Kuvendit[20] faktikisht ngushton fushëveprimin e dispozitës përkatëse të Statutit, për shkak të mospërputhjes së përkufizimeve. Specifikisht, neni 5 i rregullores specifikon shprehimisht vetëm përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik dhe të shoqërisë civile, kurse neni 33 i Statutit përmban një përkufizim më të gjerë, pasi që i referohet publikut. Ngjashëm sikur neni 4, pjesa dërrmuese e dispozitave të nenit 5 në thelb nuk dallojnë nga dispozitat përkatëse të Statutit të Komunës. Më tej, as ky nen nuk parasheh qasjen e qytetarëve në të gjitha dokumentet që i shqyrtohen dhe nxirren nga ana e komiteteve të përhershme të Komunës, e as vendos mekanizma, procedura e standarde më të hollësishme për të lehtësuar ushtrimin nga ana e qytetarëve të së drejtës për qasje në këto dokumente. Në përgjithësi, të njëjtat boshllëqe të përmendura më sipër vërehen në dispozitat e rregullores që kanë të bëjnë me peticionet[21], tubimet me publikun[22], konsultimin publik të akteve komunale[23] dhe qasjen në dokumente zyrtare[24] të Komunës.

Pjesa në vijim përmbledh gjetjet e hulumtimit në terren në Komunën e Prizrenit.

Sa i përket ***kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal***, stafi i kësaj Komune përgjegjës për komunikim dhe informim publik kanë treguar njohuri të konsiderueshme, ndonëse jo të kënaqshme, të dispozitave të Statutit që synojnë zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të shpjeguara në pjesën hyrëse të këtij studimi. Kjo pasi që ata kanë listuar vetëm ato dispozita të Statutit që rregullojnë mekanizmat e realizimit të kërkesave për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen e Komunës, konsultimet publike, dhe tubimet publike me qytetarë. Më tej, kjo Komunë ka përmendur Rregulloren Komunale për Transparencë (të shpjeguar më hollësisht më sipër), por nuk kanë arritur të shpjegojnë çfarë obligimesh, strukturash dhe resursesh specifike brenda strukturave komunale parasheh ajo me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese dhe ligjore. E njëjta vlen sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të parapara me këtë akt, pra kjo Komunë nuk ka dhënë asnjë sqarim mbi to, përfshirë mënyrën e rregullimit të klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente publike të Komunës në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje. Në anën tjetër, mungon një shpjegim i plotë mbi mekanizmat dhe masat zbatuese që parasheh ky akt për të rregulluar çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, pasi që kanë shpjeguar vetëm aspektin e dokumenteve të shkruara, pa përmendur fare atë të formateve të tjera të dokumenteve dhe materialeve të Komunës në të cilat kanë të drejtë qasje të gjithë qytetarët që flasin katër gjuhët e specifikuara në rregullore (shqipen, serbishten, boshnjakishten dhe turqishten).

Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Prizrenit, nuk është e qartë nëse Zyra e saj për Marrëdhënie me Publikun përmban strukturën e saj organizative/organogramin, pasi që nuk është dhënë ndonjë shpjegim mbi strukturën e kësaj zyre, përfshirë në kuadër të strukturës së gjithëmbarshme hierarkike të Komunës, dhe funksionimin e saj në këtë kontekst. Sa u përket Termave të Referencës (TR) së kësaj zyre,

[20] Poaty, neni 5
[21] Poaty, neni 6
[22] Poaty, neni 7
[23] Poaty, neni 8
[24] Poaty, neni 10 – 11

ndonëse është pohuar se ato ekzistojnë dhe janë të publikuara në ueb-faqen e Komunës[25], teksti i publikuar është i paqartë, pasi që pamundëson dallimin në mes të shpjegimeve kronologjike që kanë quar në themelimin e kësaj zyre dhe strukturës së supozuar të saj, në njërën anë, dhe pjesës substanciale të TR që pohohet se përmban, në anën tjetër. Së fundi sa i përket kësaj, pjesa përfundimtare e kësaj rubrike të ueb-faqes së Komunës është faktikisht një përshkrim i shkurtër i detyrave të Shefit të kësaj zyre, ndërkohë që në kuadër të hulumtimit në terren kjo Komunë ka deklaruar se kanë një plan (siç duket, për shtimin e numrit të zyrtarëve në kuadër të kësaj zyre), por se një gjë e tillë nuk është e mundur për shkak të kufizimeve ligjore për mos-rritjen e numrit të të punësuarve në Komunë.

Në nivelin e ***kornizës së politikave dhe planeve zbatuese***, Komuna e Prizrenit nuk ka hartuar ndonjë dokument politikash ose plan zbatues apo plan vjetor të punës që prek fushën e komunikimit dhe informimit publik. Rrjedhimisht, ajo nuk ka vendosur objektiva për të arritur në këtë fushë, e as aktivitete për arritjen e tyre dhe mekanizma e masa për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre. E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin aktual.

Kur jemi te ***korniza dhe kapacitetet institucionale*** për komunikim dhe informim publik, përveç vështirësive të përmendura më sipër që kanë të bëjnë me kornizën që rregullon funksionimin e saj, sipas të dhënave të ofruara nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun e kësaj Komune nuk është e qartë nëse në kuadër të saj ekzistojnë dhe vihen në zbatim standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës, pasi që është deklaruar se ato aplikohen nëpër drejtori komunale. Sa u përket resurseve njerëzore, kjo Komunë ka deklaruar se Shefi i zyrës në fjalë ka përfunduar specializim pas-universitar, ka përvojë pune mbi pesëvjeçare dhe ka ndjekur trajnime relevante me kohëzgjatje gjithsej rreth pesë muaj (ndonëse nuk ka dhënë ndonjë të dhënë mbi temat e tyre), por nuk ka dhënë ndonjë shifër mbi resurset e tjera të alokuara për të mundësuar funksionimin e kësaj zyre (vetëm kanë deklaruar se aktivitetet e saj mbulohen nga linja buxhetore e Kryetarit të Komunës). E njëjta vlen mbi resurset e alokuara për zbatimin e aktiviteteve që ndërlidhen me komunikimin dhe informimin publik me rastin e miratimit të dokumenteve të politikave gjatë këtij viti dhe planit vjetor të punës, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë ose e dhënë, si dhe resurset e përgjithshme të alokuara për funksionimin e kësaj zyre gjatë vitit aktual.

Sa u përket ***çështjeve të zbatimit***, kjo Komunë ka listuar gjashtë media lokale (*TV Besa*, *TV Prizreni*, *TV Opinioni*, *TV Yeni Dönem*, *Radio Helix* dhe *Radio Prizreni*) dhe kanë deklaruar se kanë komunikim ditor me to, por nuk kanë listuar asnjë lloj aktiviteti për të cilat komunikojnë me to. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes se organizatave lokale të shoqërisë civile të përfshira deri më tani në punën e kësaj Komune, pasi që vetëm kanë përmendur katër pre tyre (KDI, Qendrën Rinore në Prizren, Shoqatën Ekologjike në Prizren dhe shoqatat e gruas), por nuk kanë specifikuar kohëzgjatjen dhe rolin e përfshirjes së secilës prej tyre. Kur jemi te përfshirja e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave që nga fillimi, kjo Komunë ka ofruar vetëm të dhënat për vitin e kaluar dhe atë aktual, duke saktësuar se gjatë vitit 2011 dhe tremujorit të parë të vitit 2012 kanë miratuar gjithsejtë 81 vendime të natyrave të ndryshme, 3 rregullore komunale dhe një strategji për politikat rinore, por nuk kanë përmendur asnjë akter jashtë-qeveritar të përfshirë në hartimin e tyre. Në anën tjetër, është deklaruar shprehimisht se asnjë akter i tillë nuk është përfshirë në zbatimin e legjislacionit dhe dokumenteve lokale të politikave, pasi që është thënë se Kryetari i Komunës është përgjegjës për zbatimin e të gjitha vendimeve të marra

[25] *Komuna e Prizrenit – Zyra për Komunikim dhe Informim*, http://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Zyra-per-komunikim-dhe-informim.aspx

nga Kuvendi i Komunës. Sipas të dhënave të Komunës së Prizrenit, gjatë periudhës maj 2011 – maj 2012 asnjë akter jashtë-qeveritar nuk është përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve të saj të politikave. Së fundi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet (në shqip, serbisht, boshnjakisht dhe turqisht), por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse konferenca shtypi për të drejtën e qytetareve për qasje në dokumente komunale është përmendur si aktiviteti i vetëm shtesë për komunikim dhe informim publik.

4. Komuna e Mitrovicës

Statuti i Komunës së Mitrovicës, i cili ka hyrë në fuqi më 23 shtator 2011 (i plotësuar-ndryshuar), vendos një numër mekanizmash për të siguruar qasjen në dokumente publike të kësaj Komune dhe transparencën e punës së organeve komunale. Ai përcakton se në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve të tij, si dhe në të gjitha mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, lejohet pjesëmarrja e publikut, përfshirë përfaqësuesit e mediave, përveç kur "natyra e çështjes që diskutohet mund të marrë përmasa që mund të jenë të dëmshme për interesin e përgjithshëm publik". Përveç kësaj, Statuti gjithashtu u garanton qytetarëve të drejtën për qasje në dokumentet e Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi mbi qasjen në dokumente zyrtare. Së treti, ai përcakton tubimet publike dhe format e tjera të konsultimeve dhe këshillimeve si forma të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjen të Komunës, e në anën tjetër e obligon këtë të fundit që të përmbushë këto kërkesa përmes mekanizmave të tillë si fushata informative dhe promovuese, komunikim të vazhdueshëm me grupe të interesit, anketa, shpallje publike të propozimeve të ndryshme, takime e seanca publike, komitete këshillëdhënëse dhe referendume lokale. Së fundi, qytetarët kanë të drejtë të propozojnë rregullore komunale, të cilat miratohen pas konsultimeve me qytetarë.[26]

Tubimet e rregullta publike me qytetarët paraqesin një mekanizëm tjetër të rëndësishëm të paraparë me Statut. Komuna është e obliguar që të organizojë tubime të tilla së paku dy herë në vit, në të cilat tubime përfaqësuesit komunalë informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e aktiviteteve dhe të politikës zhvillimore komunale. Këto tubime janë të hapura për mbarë publikun dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit, të cilët mund të marrin nisma, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara. Koha, dita dhe vendi i mbajtjes së tyre shpallet nga Komuna përmes mjeteve të informimit publik, dy javë para mbajtjes së tyre.[27] Më tej, Kuvendi Komunal është i obliguar të publikojë njoftime publike para secilës mbledhjeje të tij. Këto njoftime duhet të përmbajnë propozimin e rendit të ditës, datën, orën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, dhe duhet të publikohen të paktën shtatë ditë pune para mbledhjes përkatëse, ose në raste urgjente (përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme) tri ditë më herët.[28] Në nivel të strukturave institucionale, Statuti e obligon Kuvendin Komunal që të themelojë komitete këshillëdhënëse, me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, të cilët përbëhen nga qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, dhe ofrojnë propozime e mendime dhe kryejnë hulumtime që ndërlidhen me nismat e Kuvendit të Komunës, në pajtim me Statutin.[29] Komuna e Mitrovicës gjithashtu obligohet të publikojë raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal, dhe pas miratimit nga Kuvendi Komunal.[30] Për dallim nga ajo e Prizrenit, kjo Komunë

[26] *Statuti i Komunës së Mitrovicës*, neni 11 dhe 12, në dispozicion në http://kk.rks-gov.net/mitrovice/getattachment/Municipality/Statut/Statuti-i-Komunes-se-Mitrovices---2011-(1).pdf.aspx
[27] Poaty, neni 13 dhe 14
[28] Poaty, neni 32
[29] Poaty, neni 41, paragrafi 5, 6 dhe 7
[30] Poaty, neni 64

gjithashtu obligohet të përkrah funksionimin e organizatave jofitimprurëse, nëse këto të fundit ofrojnë shërbime në kuadër të përgjegjësive të Komunës, gjë që duhet të bëhet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneritetit dhe në përputhje me ligjin në fuqi.[31]

Komuna e Mitrovicës gjithashtu ka vënë në fuqi ***Rregulloren Komunale për Transparencë***, e cila është miratuar nga Kuvendi Komunal më 31 mars 2011. Kjo rregullore synon rritjen e transparencës së punës së organeve të Komunës, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal, vendosjen e rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte, dhe zbatimin e praktikave të mira administrative për qasje në dokumente zyrtare. Ajo mundëson pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, mbledhjet e publikut, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, si dhe qasjen në dokumente zyrtare të Komunës.[32] Dispozitat që obligojnë Komunën të mbajë mbledhje të hapura për publikun janë në thelb të njëjta me ato që përmban Statuti i Komunës.[33] Kjo rregullore gjithashtu e obligon Komunën që të publikojë aktet e saja: buxheti dhe planet e Komunës janë shpallur si dokumente publike pa kufizime, kurse vendimi për aktet komunale në të cilat nuk lejohet qasja e publikut mund të merret vetëm kur është në pyetje mbrojtja e interesit publik, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.[34]

Sa u përket takimeve me publikun, përveç rregullave që parashihen në kuadër të Statutit, kjo rregullore përcakton listën e zyrtarëve të Komunës që janë të obliguar të marrin pjesën në to (Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës, Kryesuesi dhe Zëvendës-kryesuesi i Kuvendit Komunal, drejtorët e drejtorive komunale, kryesuesit e komiteteve, udhëheqësi i personelit dhe zyrtarët kompetentë për çështjet e vendosura në rendin e ditës), kurse nuk është përcaktuar ndonjë afat kohor për Kuvendin e Komunës që t'i shqyrtojë kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku në këto takime.[35] Më tej, kjo rregullore përcakton rregullat për konsultime publike të Komunës, ku shprehimisht përfshihen Statuti dhe rregulloret komunale. Zyra për Informim është përgjegjëse për të njoftuar publikun për mbajtjen e seancave të konsultimit publik, ndërsa të interesuarit gjithashtu mund të paraqesin rekomandimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në formë të shkruar. Këto të fundit i dërgohen Kuvendit Komunal për miratim.[36]

Së fundi, përderisa dispozitat për qasje në dokumente zyrtare të Komunës[37] janë në thelb të njëjta me ato që vendos Statuti, kjo rregullore obligon Komunën që të sigurojë qasjen e qytetarëve në raportet e saja vjetore[38], dhe që të hartojë e zbatojë një plan veprimi për transparencë.[39] Ky i fundit duhet të përmbajë aktivitete konkrete për përmirësimin e transparencës: raportim më të shpeshtë në media (për çështje që lidhen me përdorimin e buxhetit të Komunës, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës së komunës, planifikimin urban, investimet, të hyrat e Komunës si dhe çështje të tjera me interes të përgjithshëm), organizimi i seancave pyetje-përgjigje dhe i konferencave apo debateve me gazetarë për çështje që janë me interes për publikun, ndërtimin e ueb-faqes zyrtare të Komunës ose freskimin e saj (në të cilat publikohen planet dhe raportet e punës së Komunës, kalendari i mbledhjeve, numëratori

[31] Poaty, neni 68, paragrafi 3, 4 dhe 5
[32] *Rregullorja Komunale për Transparencë*, Komuna e Mitrovicës, neni 1 dhe 2, në dispozicion në https://kk.rks-gov.net/mitrovice/getattachment/Shpalljet/Rregulloret/Rregulloret-2011/Rregullorja-Nr_-01-2011-per-transparence.pdf.aspx
[33] Poaty, neni 4 dhe 5
[34] Poaty, neni 6
[35] Poaty, neni 8
[36] Poaty, neni 9
[37] Poaty, neni 10
[38] Poaty, neni 12
[39] Poaty, neni 13

telefonik dhe informacione të personave të kontaktit sipas fushave të caktuara), si dhe botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve orientuese që përmbajnë informata me rëndësi për publikun.

Pjesa në vijim përmbledh gjetjet e hulumtimit në terren në Komunën e Mitrovicës.

Sa i përket ***kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal***, stafi i kësaj Komune përgjegjës për komunikim dhe informim publik kanë treguar njohuri të kënaqshme të dispozitave të Statutit që synojnë zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të shpjeguara në pjesën hyrëse të këtij studimi. Kjo pasi që ata kanë listuar të gjitha dispozitat relevante të Statutit që rregullojnë qasjen në dokumente zyrtare të Komunës dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Më tej, kjo Komunë ka përmendur Rregulloren Komunale për Transparencë (të shpjeguar më hollësisht më sipër), por nuk kanë arritur të shpjegojnë çfarë obligimesh, strukturash dhe resursesh specifike brenda strukturave komunale parasheh ajo me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese dhe ligjore. Gjendja duket pak më e mirë sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të parapara me këtë akt, pasi që kjo Komunë ka listuar disa prej tyre: transparencën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij, publikimin e akteve të Komunës, peticionet, tubimet me qytetarë, konsultimet publike dhe qasjen në dokumente zyrtare të Komunës. Në anën tjetër, ata nuk kanë dhënë asnjë sqarim mbi mënyrën e rregullimit të klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje. Më tej, duket se ky akt nuk parasheh mekanizma dhe masa zbatuese që rregullojnë çështjen e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, pasi që kanë deklaruar se nuk ka mekanizma të tillë përveç obligimeve ligjore në fuqi. Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Mitrovicës, zyra komunale përgjegjëse për komunikim dhe informim me publikun ka strukturën organizative/ organogramin, Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrime të Vendeve të Punës (PVP) për dy zyrtarë, por megjithatë nuk është dhënë përmbajtja e këtyre dokumenteve e as ndonjë shpjegim mbi këtë.

Në nivelin e ***kornizës së politikave dhe planeve zbatuese***, as Komuna e Mitrovicës nuk ka hartuar ndonjë dokument politikash ose plan zbatues apo plan vjetor të punës që prek fushën e komunikimit dhe informimit publik. Rrjedhimisht, ajo nuk ka vendosur objektiva për të arritur në këtë fushë, e as aktivitete për arritjen e tyre dhe mekanizma e masa për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre. E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin aktual.

Kur jemi te ***korniza dhe kapacitetet institucionale*** për komunikim dhe informim publik, përveç vështirësive të përmendura më sipër që kanë të bëjnë me kornizën që rregullon funksionimin e saj, sipas të dhënave të ofruara nga kjo Komunë, vlerësimi i punës kryhet në baza gjashtëmujore dhe vjetore, por megjithatë nuk është e qartë se çfarë standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës mund të ketë. Sa u përket resurseve njerëzore, kjo Komunë ka deklaruar se ka dy anëtarë personeli që merren me komunikim dhe informim publik, të dy me studime universitare të përfunduara, me përvojë prej 12, përkatësisht 30 vitesh (ndonëse nuk është e qartë relevanca e saj), vetëm njëri nga të cilët është thënë se ka ndjekur trajnime prej rreth një muaji (ndonëse nuk kanë dhënë ndonjë të dhënë mbi temat e trajnimeve), por kanë deklaruar se kjo zyrë nuk posedon buxhet të veçantë për funksionimin e saj. Paksa me tepër të dhëna janë ofruar sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e aktiviteteve që ndërlidhen me komunikimin dhe informimin publik me rastin e miratimit të dokumenteve të politikave gjatë këtij viti dhe planit vjetor të punës, pasi që është dhënë një shifër prej €10,000, e alokuar këtë vit për botimin e revistës mujore të Komunës dhe të disa broshurave.

Sa u përket ***çështjeve të zbatimit***, kjo Komunë ka listuar një numër mediesh lokale dhe nacionale (*Koha Ditore*, *Zëri*, *Kosova Sot*, *Kosovapress*, *Kosovalive*, *RTK*, *KTV*, *TV Klan*, *Tv21*, *RTV Mitrovica*, *Radio Ylberi*, etj.) dhe kanë deklaruar se kanë komunikim ditor me to, por nuk kanë listuar asnjë lloj aktiviteti për të cilat komunikojnë me to. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes se organizatave lokale të shoqërisë civile të përfshira deri më tani në punën e kësaj Komune, pasi që vetëm kanë përmendur një pre tyre (*CBM*), por kanë përmendur ngjarje politike në përgjithësi, dhe nuk kanë shpjeguar kohëzgjatjen dhe rolin e përfshirjes së secilës prej tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave që nga fillimi, kjo Komunë nuk ka ofruar asnjë të dhënë. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes së akterëve të tillë në zbatimin e tyre, kurse sa i përket monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve lokale të politikave kanë përmendur organizatën CBM, por nuk kanë dhënë asnjë hollësi të mëtejshme. Së fundi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara një numër i madh dokumentesh, por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse revista e Komunës, fletëpalosjet dhe broshurat janë përmendur si aktivitete shtesë për komunikim dhe informim publik.

5. Komuna e Gjakovës

Statuti i Komunës së Gjakovës, i cili ka hyrë në fuqi më 26 dhjetor 2008, vendos një numër mekanizmash për të siguruar qasjen në dokumente publike të saj dhe transparencën e punës së organeve komunale. Sipas këtij statuti, mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve janë të hapura për publikun, përveç në rastet kur një gjë e tillë mund të rrezikojë sigurinë publike ose kur rrezikohet zbulimi i informatave senzitive, siç janë ato që janë të klasifikuara si të besueshme nga LQDP, ose të natyrës personale, biznesore dhe që ka të bëjë me procedura gjyqësore. Në raste të mbledhjeve të mbyllura, publiku duhet të informohet mbi arsyet e kësaj dhe Kuvendi mund të miratojë rregulla të veçanta për këtë. Kuvendi Komunal gjithashtu obligohet të publikojë njoftime publike para secilës mbledhjeje të tij, të cilat duhet të përmbajnë propozimin e rendit të ditës, datën, orën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, dhe duhet të publikohen të paktën shtatë ditë pune para mbledhjes përkatëse, ose në raste urgjente (përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme) tri ditë më herët. Ky Statut gjithashtu vendos rregulla të hollësishme sa i përket informimit të subjekteve të interesuara për mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve të tij, të cilat e obligojnë Zyrën për Informim që për çdo mbledhje të tillë të njoftojë publikun përmes shpalljeve publike, mediave lokale dhe ueb-faqes së Komunës.[40] Në nivel të strukturave institucionale, Statuti e obligon Kuvendin Komunal që të themelojë komitete konsultative sektoriale për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Këto komitete përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, dhe mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e Kuvendit Komunal.[41]

Statuti i kësaj Komune gjithashtu përmban dispozita për informimin dhe konsultimin e publikut. Sipas këtyre dispozitave, Komuna obligohet të mbajë së paku dy herë në vit takime publike, në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë dhe ku Komuna informon publikun mbi aktivitetet e saj e këta të fundit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime. Më tej, Komuna është e obliguar t'i informojë qytetarët për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, Kuvendi obligohet të miratojë rregulloren komunale për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të Komunës, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së publikut në

[40] *Statuti i Komunës së Gjakovës*, neni 24 dhe 37, në dispozicion në http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/Municipality/Statut/statuti-i-komunes.pdf.aspx
[41] Poaty, neni 36

vendimmarrje dhe lehtësimit të qasjes së tij në dokumentet zyrtare të saj.[42] Kjo Komunë gjithashtu obligohet të publikojë raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal të Komunës, dhe pas miratimit nga Kuvendi Komunal.[43]

Komuna e Gjakovës gjithashtu ka vënë në fuqi ***Rregulloren Komunale për Transparencë***, e cila është miratuar nga Kuvendi Komunal më 28 prill 2009. Kjo rregullore përkufizon parimet, kushtet dhe kriteret për qëllim të forcimit të transparencës së organeve të Komunës, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të Komunës dhe nxitjen e praktikave të mira administrative për qasjen në dokumente zyrtare. Ajo rregullon qasjen e personave fizikë apo juridikë në të gjitha dokumentet publike të Komunës, pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, mbledhjet me publikun, detyrimin për njoftime publike, konsultimin e publikut, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.[44] Dispozitat që obligojnë Komunën të mbajë mbledhje të hapura për publikun janë në thelb të njëjta me ato që përmban Statuti i Komunës.[45] Kjo rregullore gjithashtu e obligon Komunën që të publikojë aktet e saj – përfshirë rregulloret, vendimet dhe aktet e tjetra administrative të Kuvendit të Komunës, buxheti i Komunës dhe planet komunale – një javë pas mbledhjes në të cilën janë ato, dhe atë përmes shpalljeve publike, mediave lokale dhe ueb-faqes së Komunës.[46] Më tej, kjo rregullore e obligon Komunën që brenda 30 ditëve t'u përgjigjet kërkesave të qytetarëve për informim dhe peticioneve të tyre që ndërlidhen me çfarëdo çështje që bie në fushëveprimin e Komunës.[47]

Dispozitat e kësaj rregulloreje mbi takimet me publikun janë në thelb të njëjta me ato që përmban Statuti i Komunës, përveç se rregullorja parasheh listën e zyrtarëve të Komunës që janë të obliguar të marrin pjesën në to (Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës, Kryesuesi he Zëvendës-kryesuesi i Kuvendit të Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, kryesuesit e komiteteve, udhëheqësi i personelit dhe zyrtarët kompetentë për çështjet të e vendosura në rendin e ditës) dhe obligon Kuvendin Komunal që kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku t'i shqyrtojë brenda 30 ditëve.[48] Në anën tjetër, për diskutime publike janë vendosur të njëjtin fushëveprim rregullash që vlejnë për mbajtjen e mbledhjeve të hapura me publikun, përkatësisht format dhe përmbajtjen e informimit të publikut për këtë qëllim. Ajo gjithashtu përcakton çështjet të cilat i nënshtrohen diskutimeve publike: projekt-buxheti i Komunës, planet rregullative Komunale, Statuti, rregulloret si dhe propozim-projektet që ndërlidhen me çështje me interes të përgjithshëm komunal.[49]

Së fundi, përderisa dispozitat për qasje në dokumente zyrtare të Komunës[50] janë në thelb të njëjta me ato që vendos Statuti, kjo rregullore obligon Komunën që të hartojë dhe zbatojë një plan veprimi për transparencë.[51] Përmes këtij të fundit, Komuna duhet t'i mundësojë publikut monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për vetëqeverisja lokale në këtë Komunë dhe legjislacionit në bazë të të cilit zhvillojnë veprimtarinë e tyre organet e administratës publike të saj. Kjo dispozitë gjithashtu parasheh një varg aktivitetesh për përmirësimin e transparencës: raportim më të shpeshtë në media (për çështje

[42] Poaty, neni 65
[43] Poaty, neni 79
[44] *Rregullorja Komunale për Transparencë*, Komuna e Gjakovës, neni 1, në dispozicion në http://kk.rks-gov.net/gjakove/getattachment/0b61583a-c12b-4dc5-ba1d-9e9e62221f7f/Rregullore-per-transparence.aspx
[45] Poaty, neni 2 dhe 3
[46] Poaty, neni 4
[47] Poaty, neni 5
[48] Poaty, neni 6
[49] Poaty, neni 7
[50] Poaty, neni 8
[51] Poaty, neni 9

që lidhen me përdorimin e buxhetit të Komunës, zhvillimin ekonomik, shfrytëzimin e pronës së Komunës, planifikimin urban, planifikimin për përkujdesje shëndetësore dhe mirëqenie sociale, planifikimin për zbatimin e proceseve në lëmin e Arsimit , Kulturës, Rinisë, Sportit, në investimet dhe të hyrat e Komunës, si dhe çështje tjera me interes të përgjithshëm), organizimi i seancave pyetje-përgjigje dhe i konferencave apo debateve me gazetarë për çështje që janë me interes për publikun, ndërtimin e ueb-faqes zyrtare të Komunës ose freskimin e saj ekzistuese (në të cilat publikohen planet dhe raportet e punës së Komunës, kalendari i mbledhjeve, numëratori telefonik dhe informata të personave të kontaktit sipas fushave të caktuara), si dhe botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve orientuese që përmbajnë informata me rëndësi për publikun.

Pjesa në vijim përmbledh gjetjet e hulumtimit në terren në Komunën e Gjakovës.

Sa i përket ***kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal***, stafi i kësaj Komune përgjegjës për komunikim dhe informim publik kanë treguar njohuri të pamjaftueshme të dispozitave të Statutit që synojnë zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të shpjeguara në pjesën hyrëse të këtij studimi. Kjo pasi që ata vetëm i janë referuar Statutit, por nuk kanë dhënë përmbajtjen e dispozitave të Statutit që rregullojnë përgjegjësinë ligjore të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Më tej, kjo Komunë ka përmendur Rregulloren Komunale për Transparencë (të shpjeguar më hollësisht më sipër), por nuk kanë arritur të shpjegojnë çfarë obligimesh, strukturash dhe resursesh specifike brenda strukturave komunale parasheh ajo me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese dhe ligjore. E njëjta vlen sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të parapara me këtë akt, pasi që kjo Komunë nuk ka dhënë asnjë të dhënë shtesë, si dhe mënyrës së rregullimit të klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje, pasi që vetëm i janë referuar ligjit përkatës dhe Rregullores Komunale për Transparencë. Më tej, sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, ata kanë deklaruar se përballen me mungesë kapacitetesh të mjaftueshme për të siguruar përkthim në gjuhën serbe. Sipas të dhënave të ofruara nga Komuna e Gjakovës, Zyra për Informim Publik është pjesë e strukturës organizative të Komunës dhe funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, kurse nuk është e qartë nëse kjo zyrë ka Termat e Referencës (TR), kurse sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP), kanë deklaruar se në kuadër të saj punojnë tre zyrtarë dhe se PVP-të janë në hartim e sipër.

Në nivelin e ***kornizës së politikave dhe planeve zbatuese***, Komuna e Gjakovës kanë deklaruar se Zyra e Informimit Publik ka punuar dhe vepruar në bazë të një strategjie dhe plani veprimi në fushën e komunikimit dhe informimit publik, por nuk kanë ofruar ndonjë përmbajtje të këtyre dokumenteve. Në nivelin e objektivave, vetëm i janë referuar sensibilizimit të publikut dhe bashkëpunimit me ta, por nuk kanë përmendur ndonjë aktivitet për arritjen e tyre, e as nuk kanë përmendur mekanizma e masa për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre. E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin aktual.

Kur jemi te ***korniza dhe kapacitetet institucionale*** për komunikim dhe informim publik, sipas të dhënave të ofruara nga kjo Komunë, vlerësimi i punës kryhet në baza gjashtëmujore dhe vjetore, por megjithatë nuk është e qartë se çfarë standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës mund të ketë. Sa u përket resurseve njerëzore, kjo Komunë ka deklaruar se Zyra për Informim Publik përbëhet nga tre zyrtarë, që të tre me studime të larta të përfunduara, me përvojë prej 10, 13, përkatësisht 30 vitesh (ndonëse nuk është e qartë relevanca e saj), kurse secili ka ndjekur trajnime prej një deri në tre muaj (ndonëse nuk kanë dhënë ndonjë të dhënë mbi temat e trajnimeve). Sa i përket buxhetit, ata kanë deklaruar se kjo zyrë nuk posedon buxhet të veçantë për funksionimin e saj, por

funksionon në kuadër të buxhetit të alokuar Kryetarit të Komunës, por nuk është dhënë ndonjë shifër konkrete. E njëjta vlen sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e aktiviteteve që ndërlidhen me komunikimin dhe informimin publik me rastin e miratimit të dokumenteve të politikave gjatë këtij viti dhe planit vjetor të punës.

Sa u përket ***çështjeve të zbatimit***, kjo Komunë ka listuar një numër mediesh lokale dhe nacionale (*Syri Vision*, *Radio Gjakova*, *TOP Radio*, *RTK*, *TV KLAN*, *TV 21*, *KTV*, *Radio Dukagjini*, *Lajm*, *Bota Sot*, *Koha Ditore*, *Zëri* dhe *Kosova Sot*) dhe kanë deklaruar se kanë komunikim të rregullt me to, por nuk kanë listuar asnjë lloj aktiviteti për të cilat komunikojnë me to. E njëjta vlen sa i përket përfshirjes se organizatave lokale të shoqërisë civile të përfshira deri më tani në punën e kësaj Komune, pasi që vetëm kanë përmendur dy prej tyre (*Shoqatën e Intelektualëve "Jakova" dhe Klubin Letrar "Gjon Nikollë Kazazi"*), por kanë përmendur ngjarje politike në përgjithësi e as kanë shpjeguar kohëzgjatjen dhe rolin e përfshirjes së secilës prej tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave që nga fillimi, kjo Komunë nuk ka ofruar asnjë të dhënë relevante, kurse ka listuar vetëm *BIRN*-in si akter jashtë-qeveritar të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimit të zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve lokale të politikave, por nuk kanë dhënë asnjë hollësi të mëtejshme. Së fundi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës, por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse kanë deklaruar se nuk kanë kryer ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik.

6. Komuna e Podujevës

Statuti i Komunës së Podujevës, i cili ka hyrë në fuqi më 12 tetor 2009, vendos një numër mekanizmash për të siguruar qasjen në dokumente publike dhe transparencën e punës së organeve komunale. Sikur Komunat e tjera, ky Statut përcakton se mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve janë të hapura për publikun, mjetet e informimit, dhe subjektet e tjerë të interesuar, përveç në rastet kur një gjë e tillë mund të rrezikojë sigurinë publike ose zbulimin e informatave senzitive, siç janë ato që janë të klasifikuara si të besueshme nga LQDP, ose të natyrës personale, biznesore dhe që kanë të bëjnë me procedura gjyqësore. Në raste të mbledhjeve të mbyllura, Kuvendi Komunal, me vendim, jep arsyetimin për mbledhjet tërësisht ose pjesërisht të mbyllura për publikun. Kuvendi Komunal gjithashtu obligohet që përmes Zyrës për Informim, të publikojë njoftime publike para secilës mbledhjeje të tij. Këto njoftime duhet të përmbajnë propozimin e rendit të ditës, datën, orën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, dhe duhet të publikohen të paktën shtatë ditë pune para mbledhjes përkatëse, ose në raste të mbledhjeve të jashtëzakonshme, tri ditë më herët. Ky Statut gjithashtu vendos rregulla të hollësishme sa i përket informimit të subjekteve të interesuara për mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve të tij, të cilat e obligojnë Zyra për Informim njofton publikun përmes shpalljeve publike, mediave lokale dhe ueb-faqes së Komunës.[52] Në nivel të strukturave institucionale, Statuti e obligon Kuvendin Komunal që të themelojë komitete të tjera, të cilat në përbërjen e tyre mund të kenë përfaqësues të shoqërisë civile, por shumica e anëtarësisë së tyre duhet të jenë anëtarë të Kuvendit Komunal. Sa u përket komiteteve konsultative, ato mund të themelohen nga Kuvendi Komunal, pas propozimit nga Kryetari i Komunës, nga komitetet e përhershme në Komunë dhe nga grupe qytetarësh. Anëtarë të komiteteve konsultative mund të jenë qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.[53]

[52] *Statuti i Komunës së Podujevës*, neni 39, në dispozicion në http://kk.rks-gov.net/podujeve/getattachment/Municipality/Assembly/Statut/Statuti.pdf.aspx
[53] Poaty, neni 53 dhe 71

Statuti i Komunës së Podujevës gjithashtu përmban dispozita për informimin dhe konsultimin e publikut. Sipas këtyre dispozitave, Komuna obligohet të mbajë së paku dy herë në vit takime publike, në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë dhe ku Komuna informon publikun mbi aktivitetet e saj e këta të fundit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime. Më tej, Komuna është e obliguar t'i informojë qytetarët për planet e programet e saj të rëndësishme me interes publik, si dhe të miratojë rregulloren komunale që promovon transparencën e organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të saj, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe lehtësimit të qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të saj. Më tej, çdo person ose organizatë e interesuar ka të drejtë t'i parashtrojë Komunës kërkesë për informata mbi veprimtarinë e saj, dhe Kuvendi Komunal është e obliguar që të shqyrtojë kërkesa të tilla, kurse Kryetari i Komunës ose ndonjë zyrtar i autorizuar, që të kthejë përgjigje me shkrim, brenda 30 ditësh pas pranimit të një kërkese të tillë.[54] Kjo Komunë gjithashtu obligohet të sigurojë transparencë në hartimin e akteve normative të saj, publikojë raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal të Komunës, dhe pas miratimit nga Kuvendi Komunal, përfshirë, rregulloret, buxhetin e Komunës dhe vendimet, të cilat duhet të kalojnë nëpër diskutime publike dhe konsultime para miratimit të tyre. Përveç kësaj, Statuti e obligon Komunën që, përmes Zyrës për Informim, t'i bëjë publike të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të saj (përfshirë buxhetin komunal), përveç atyre publikimi i të cilave kufizohet nga legjislacioni për qasje në dokumente zyrtare, një javë pas miratimit të tyre. Së fundi, ai garanton të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare të Komunës, dhe e obligon këtë të fundit të miratojë një rregullore dhe plan veprimi komunal për transparencë, me qëllim të rritjes së transparencës së vendimmarrjes dhe veprimtarisë së saj.[55]

Komuna e Podujevës gjithashtu ka vënë në fuqi ***Rregulloren për Transparencën e Punës së Organeve të Komunës***, e cila është miratuar nga Kuvendi Komunal më 15 shtator 2010. Kjo rregullore përkufizon përcaktohen obligimet dhe përgjegjësitë e organeve komunale për punë transparente dhe krijimin e mundësive dhe mekanizmave për informim dhe përcjellje të drejtpërdrejtë nga të gjithë të interesuarit të aktiviteteve të këtyre organeve. Njëjtë sikur Statuti, ajo u garanton të gjithë qytetarëve të komunës të drejtën për qasje në dokumente dhe informata zyrtare të saj, në dobi të interesave të përbashkëta të qytetarëve.[56] Dispozitat që obligojnë Komunën të mbajë mbledhje të hapura për publikun janë në thelb të njëjta me ato që përmban Statuti i Komunës.[57] Ajo e obligon Komunën që të sigurojë hapësirë dhe kushte adekuate për pjesëmarrjen e qytetarëve të interesuar në mbledhjet e hapura të Kuvendit Komunal dhe të komiteteve të tij.[58] Kjo rregullore gjithashtu e obligon Komunën që të bëjë publike angazhimet, vendimet e nxjerra, qëndrimet e marra për çështje të caktuara, mënyrën e realizimit të projekteve dhe çështjeve të tjera, shumat e kategorive buxhetore sipas destinimeve si dhe dinamikën e shpenzimeve buxhetore. Më tej, ekzekutivi komunal obligohet që të informojë hollësisht publikun mbi përmbajtjen e programit të punës si dhe të ofrojë sqarime profesionale për çështje nga kompetencat dhe përgjegjësitë e tij.[59]

Sa u përket mjeteve për sigurimin e transparencës, kjo rregullore parasheh përdorimin e komunikatave e konferencave për shtyp, ueb-faqes së Komunës, mjeteve lokale të informimit, shpalljeve publike e

[54] Poaty, neni 66 dhe 67
[55] Poaty, neni 73, 74, 75 dhe 76
[56] *Rregullorja Komunale për Transparencë*, Komuna e Podujevës, neni 1, 2 dhe 3, në dispozicion në http://kk.rks-gov.net/podujeve/getattachment/205b580e-d110-4dd3-aa0a-535ec01e8d50/Rregullore-per-transparencen-e-punes-te-institucio.aspx
[57] Poaty, neni 6, 7, 8 dhe 9
[58] Poaty, neni 11
[59] Poaty, neni 15, 16 dhe 17

buletineve periodike. Përveç kësaj, Kryetari i Komunës dhe drejtorët e komunalë obligohen që në një ditë të javës të caktojnë orarin e rregullt të punës me palë, për t'u mundësuar qytetarëve dhe subjekteve të interesuara të informohen, konsultohen dhe të paraqesin sugjerimet e vërejtjet e tyre mbi çështje të caktuara në kuadër të kompetencave të ekzekutivit komunal. Kjo rregullore gjithashtu parasheh funksionimi i një qendre të shërbimit për qytetarë, e cila është përgjegjëse për t'u ofruar qytetarëve informata orientuese, si dhe kërkon vendosjen në vend të dukshëm të shenjave orientuese të zyrave dhe shërbimeve komunale dhe të kutisë së ankesave, në të cilën qytetarët mund të paraqesin vërejtjet në punët e organeve komunale dhe për sjellje eventuale jokorrekte të zyrtarëve përkatës.[60]

Më tej, kjo rregullore përcakton formatin dhe përmbajtjen e kërkesave të qytetarëve, organizatave joqeveritare, grupeve të interesit dhe subjekteve të tjera, për qasje në dokumente zyrtare të Komunës. Në anën tjetër, Komuna obligohet që brenda 15 ditëve t'u përgjigjet këtyre kërkesave dhe të sigurojë qasjen në informatat e kërkuara. Në rast të refuzimit nga ana e Komunës për qasje në informatat e kërkuara, subjektet përkatës kanë të drejtë ankese në Avokatit të Popullit dhe që të iniciojnë procedurë gjyqësore.[61] Në fund, rregullorja përcakton kriteret e kufizimit të qasjes në dokumente zyrtare, të cilat janë në thelb të njëjta me ato që përcakton Statuti i Komunës.[62]

Pjesa në vijim përmbledh gjetjet e hulumtimit në terren në Komunën e Podujevës.

Sa i përket ***kornizës ligjore dhe rregullative në nivelin komunal***, stafi i kësaj Komune përgjegjës për komunikim dhe informim publik kanë treguar njohuri të kënaqshme të dispozitave të Statutit që synojnë zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të shpjeguara në pjesën hyrëse të këtij studimi, pasi që kanë dhënë përmbajtjen e të gjitha dispozitave të tij që rregullojnë përgjegjësinë ligjore të kësaj Komune për komunikim dhe informim publik. Më tej, kjo Komunë ka përmendur Rregulloren Komunale për Transparencë (të shpjeguar më hollësisht më sipër), por nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim mbi obligimet, strukturat dhe resurset specifike brenda strukturave komunale të parapara me qëllim të përmbushjes së obligimeve përkatëse kushtetuese dhe ligjore. E njëjta vlen sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të parapara me këtë akt, pasi që kjo Komunë nuk ka dhënë asnjë të dhënë shtesë, si dhe mënyrës së rregullimit të klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive të Komunës nga ato dokumente në të cilat qytetarët gëzojnë të drejtën për qasje, pasi që vetëm kanë dhënë përmbajtjen e dispozitave të Rregullores Komunale për Transparencë. Sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në këtë Komunë, ata vetëm kanë dhënë përmbajtjen e dispozitave përkatëse të Rregullores për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Komunën e Podujevës, por nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim mbi masat dhe mekanizmat zbatuese në përdorim. Sipas organogramit të saj, të dërguar nga Komuna e Podujevës, Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës. Më tej, ndonëse kanë deklaruar se kanë vënë në fuqi Termat e Referencës (TR) dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës (PVP) së kësaj zyre, dhe kanë listuar një listë të detyrave dhe përgjegjësive përkatëse, nuk është e qartë se kur kanë hyrë në fuqi ato.

Në nivelin e ***kornizës së politikave dhe planeve zbatuese***, Komuna e Podujevës ka deklaruar se nuk kanë hartuar ndonjë dokument politikash për komunikim dhe informim publik, por vetëm kanë ripërsëritur detyrat dhe obligimet e Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim. Rrjedhimisht, kjo Komunë nuk posedon një listë objektivash për komunikim dhe informim publik dhe aktivitetesh për arritjen e tyre, e as nuk kanë përmendur mekanizma e masa për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit.

[60] Poaty, neni 19, 20, 21, 22 dhe 23
[61] Poaty, neni 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31
[62] Poaty, neni 32

E njëjta vlen sa i përket reflektimit të kësaj fushe horizontale politikash publike në kuadër të planit vjetor të Komunës për vitin aktual.

Kur jemi te ***korniza dhe kapacitetet institucionale*** për komunikim dhe informim publik, kjo Komunë nuk ka dhënë shpjegime të hollësishme mbi vlerësimin e punës së zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik, po vetëm kanë deklaruar se kjo bëhet drejtpërdrejt nga Kryetari i Komunës, e rrjedhimisht nuk është e qartë se në çfarë standardesh të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës bazohet kjo. Sa u përket resurseve njerëzore, kjo Komunë ka deklaruar se Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim përbëhet nga dy zyrtarë, të dy me studime të larta të përfunduara, me përvojë prej 8, përkatësisht 13 vitesh (ndonëse nuk është e qartë relevanca e saj), kurse secili ka ndjekur trajnime prej një deri në tre muaj (ndonëse nuk kanë dhënë ndonjë të dhënë mbi temat e trajnimeve). Sa i përket buxhetit, ata kanë deklaruar se kjo zyrë nuk posedon buxhet të veçantë për funksionimin e saj, por funksionon në kuadër të buxhetit të alokuar Kryetarit të Komunës, por nuk është dhënë ndonjë shifër konkrete. E njëjta vlen në lidhje me resurset e alokuara për zbatimin e aktiviteteve për komunikim dhe informim publik me rastin e miratimit të dokumenteve të politikave gjatë këtij viti dhe planit vjetor të punës.

Sa u përket ***çështjeve të zbatimit***, kjo Komunë ka deklaruar se kanë vendosur komunikim të rregullt dhe të drejtpërdrejtë me rreth 50 media (përfshirë radiostacione, televizione, gazeta e portale në Internet) dhe kanë listuar një numër syresh, lokale dhe nacionale (*Radio Vizioni*, *Radio Llapi*, *RTK*, *RTV 21*, *TV KLAN* dhe *KTV*), por kanë përmendur vetëm mbledhjet e Kuvendit Komunal si aktivitete specifike për të cilat komunikojnë me to. Sa i përket përfshirjes se organizatave lokale të shoqërisë civile në punën e kësaj Komune deri më tani, ata kanë listuar disa prej tyre (*Ekovizioni*, *Alternative e re Llapi*, *Aureola*, *AKEA*, *KAD*, *Gratë për gratë*, *Këshilli i Veprimit Rinor*, dhe *Parlamenti Rinor*) dhe aktivitetet kryesore për të cilat komunikojnë me to: bashkëpunim në fushën e mjedisit (përfshirë ndihmë financiare për projektet e tyre, bashkëpunim në hartimin e planeve të veprimit për ambient që ka hartuar komuna, konsultime, partneritet, shkëmbim informatash, pastaj ofrimin e objektit për aktivitete të qendrës lokale rinore, dhe mbështetje në një projekt për zhdukjen e analfabetizmit nëpër zona të thella rurale. Megjithatë, nuk kanë shpjeguar kohëzgjatjen dhe rolin e përfshirjes së secilës prej tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e legjislacionit dhe politikave që nga fillimi, kjo Komunë ka listuar një numër të madh aktesh komunale, por nuk kanë përmendur asnjë akter jashtë-qeveritar të përfshirë në hartimin e tyre. Më tej, ata kanë dhënë një numër akterësh të tillë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit dhe dokumenteve lokale të politikave dhe të punës së Komunës, në përgjithësi, përfshirë monitorimin e zbatimit të dokumenteve për komunitete (nga *Balkan Sunflowers*) dhe të seancave të Kuvendit Komunal (nga *Parlamenti Rinor* dhe *Këshilli Rinor Lokal i Veprimit*). Së fundi, është thënë se në ueb-faqen e kësaj Komune janë të publikuara të gjitha dokumentet zyrtare të saj, por nuk janë dhënë hollësi të mëtejshme, kurse sa u përket aktiviteteve shtesë për komunikim dhe informim publik, kanë përmendur në përgjithësi organizimin e takimeve nëpër fshatra të komunës.

Përfundime dhe rekomandime

Siç tregojnë gjetjet e këtij studimi politikash publike, Komunat janë në fazën fillestare të kompletimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe politikave lokale që mundësojnë qasjen e publikut në dokumentet publike të tyre dhe masa të tjera për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së tyre ndaj publikut. Sa u përket dispozitave të Statuteve të tyre, të katër Komunat e mbuluara nga ky studim tash për tash mbulojnë në mënyrë mjaft gjithëpërfshirëse çështjet e komunikimit dhe informimit publik dhe qasjes së publikut në dokumente publike. Sidoqoftë, duket se nevojitet një përcaktim më i saktë i kompetencave dhe përgjegjësive të zyrave përgjegjëse për komunikim dhe informim publik.

Prandaj *rekomandohet* që Komunat të rishikojnë Statutet e tyre për të siguruar reflektimin e obligimeve që dalin nga ligjet dhe aktet nënligjore në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të zyrave të tyre që janë përgjegjëse për komunikim dhe informim me publikun.

Sa u përket rregulloreve komunale për transparencë, ky studim ka treguar se përderisa ato synojnë të rregullojnë një numër të konsiderueshëm çështjesh dhe kanë vendosur qëllime të mjaft të mëdha dhe të rëndësishme, ato përmbajnë një numër të kufizuar mekanizmash dhe masash zbatuese për të arritur këto qëllime. Përveç kësaj, ato nuk janë të harmonizuara mjaftueshëm dhe në mënyrë adekuate me ligjet dhe aktet nënligjore (përfshirë Statutet) në çështjet që ndërlidhen me transparencë dhe llogaridhënie.

Prandaj *rekomandohet* që Komunat gjithashtu të fokusohen në zhvillimin e mëtejmë të këtyre rregulloreve, me fokus në eliminimin e paqartësive dhe mospërputhjeve me legjislacionin kornizë, përkufizimin më të saktë dhe gjithëpërfshirës të çështjeve që synojnë të rregullojnë (në pajtueshmëri me dhe duke reflektuar dispozitat përkatëse ligjore dhe statutore), zbërthimin e këtyre dispozitave në mekanizma, standarde, si dhe detyra e obligime specifike për strukturat institucionale komunale (dhe atë jo vetëm për zyrat përgjegjëse për komunikim dhe informim publik, por edhe të strukturave të tjera komunale), dhe zbërthimin e obligimeve të Komunave, në veçanti sa u përket masave pasuese që dalin nga komponentët dhe aktivitetet e ndryshme në kuadër të fushës së transparencës dhe llogaridhënies, me qëllim që të sigurohet ndërlidhja me e mirë në mes të këtyre komponentëve dhe kështu të vendoset një proces ciklik i cili do të mundësonte sistematizimin e zhvillimit të legjislacionit dhe politikave lokale në këtë fushë, si dhe zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tyre.

Në nivel të strukturave institucionale përgjegjëse për komunikim dhe informim publik, ky studim ka treguar se stafi i tyre ka informata dhe njohuri të pamjaftueshme mbi kornizën ligjore dhe të politikave për komunikim dhe informim publik, por gjithashtu se është pak i informuar mbi çështjet sektoriale në kuadër të fushëveprimit të Komunave përkatëse.

Prandaj *rekomandohet* që Komunat të marrin masa në drejtim të ngritjes së kapaciteteve humane të këtyre zyrave, për të siguruar që stafi përgjegjës për komunikim dhe informim publik të njohin në hollësi dispozitat ligjore dhe politikat që kërkohet të zbatojnë, si dhe të përmirësojnë kapacitetet për zbatimin e tyre. Kjo gjithashtu kërkon që ata të jenë të përfshirë dhe të përmirësojnë dukshëm njohuritë mbi çështjet sektoriale në kuadër të fushëveprimit të Komunës. Kjo është e domosdoshme në mënyrë që të sigurohet që rregullativa komunale dhe dokumentet e politikave për fusha specifike sektoriale të reflektojnë përmasat e komunikimit dhe informimit publik. Kjo pastaj do t'u mundësonte strukturave përgjegjëse për komunikim dhe informim publik që të monitorojnë dhe të vlerësojnë më mirë zbatimin e politikave për komunikim dhe informim publik, dhe që kështu të jenë në gjendje të vlerësojnë

përparimin e përgjithshëm të Komunave në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.

Gjithashtu rekomandohet që të merren masat në vijim, që prekin çështje më të detajuara:

- Hartimi i Strukturave Organizative/Organogrameve të brendshme, Termave të Referencës dhe Përshkrimeve të Vendeve të punës së zyrave përgjegjëse për komunikim dhe informim publik dhe të stafit të tyre;

- Hartimi i planeve vjetore të punës së zyrave përgjegjëse për komunikim dhe informim publik, të cilët do të përmbanin objektiva të qarta dhe aktivitete të detajuara për arritjen e tyre; dhe

- Zhvillimi i bazës së informatave mbi komunikimin dhe bashkëpunimin me akterë jashtë-qeveritarë, në veçanti me media dhe organizata të shoqërisë civile, të cilat do të mundësonin marrjen e një pasqyre të qartë mbi qëllimet dhe llojet e aktiviteteve për të cilat komunikohet dhe bashkëpunohet me secilën prej tyre.